REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 32/2024 (JR)
Nr. 32/2 regj.

Tiranë, më 16.12.2025

**SHPALLJE**
**E**
**NJOFTIMIT PËR GJYKIMIN E ÇËSHTJES NË SEANCË PUBLIKE**

Nëpërmjet kësaj shpallje, Kolegji i Posaçëm i Apelimit, bazuar në nenin 65, pika 1 dhe 3 të ligjit nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", njofton subjektet pjesëmarrëse në proces, si dhe të gjithë personat e interesuar se, ditën e martë, në **datën 20.01.2026, ora 12:30,** do të gjykohet në seancë gjyqësore publike çështja e Juridiksionit të Rivlerësimit, me numër regjistri nr. (JR) 32/2024, datë 03.09.2024, për ankimin që Komisioneri Publik ka bërë kundër vendimit nr. 756, datë 09.04.2024 të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit Klerona Meçi.

Seanca gjyqësore publike do të zhvillohet në selinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në adresën: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr. 3, Tiranë.

Trupi Gjykues përbëhet nga gjyqtarët:

| | |
|---|---|
| **Kryesuese e Trupit Gjykues** | **Rezarta Schuetz** |
| **Relatore e Çështjes** | **Ina Rama** |
| **Gjyqtar** | **Sokol Çomo** |
| **Gjyqtare** | **Natasha Mulaj** |
| **Gjyqtare** | **Mimoza Tasi** |

Bazuar në nenin 460, pika 5 e Kodit të Procedurës Civile, kjo shpallje bëhet të paktën 15 ditë para seancës së gjykimit, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në ambientet e Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ky njoftim bëhet gjithashtu edhe në faqen e internetit të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit dhe në faqen e internetit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Gjithashtu, me njoftim individual njoftohet subjekti i rivlerësimit, në të dhënat elektronike të kontaktit të deklaruara në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, në të dhënat elektronike të tij.

**KRYESUESE E TRUPIT GJYKUES**

**GJYQTARE**

**REZARTA SCHUETZ**